



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 50/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi kryesues, Vlastimir Dimić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj për shkak të vendosjes së billbordave para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar komune në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 24.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 22.04.2012, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV dega në Ferizaj, në të cilën theksohet se me datën 22.04.2012, në orët e hershme të mëngjesit në qytetin e Ferizajt janë vendosur fotot e kandidatit të LDK-së, për kryetar komune Adem Salihaj me Nr. 27, duke e ditur se fushata zgjedhore zyrtarisht fillon me 23.04.2012. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik LDK ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, si dhe nenin 64 të LZP-së, i cili e bënë përgjegjëse KQZ-në për zbatimin e këtij ligji, duke ditur se KQZ-ja ka nxjerrë një vendim që fushata zgjedhore në Ferizaj fillon me 23 prill 2012 dhe se sipas nenit 7 të këtij vendimi fushata zgjedhore do të zgjas 5 ditë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotot e kandidatit të LDK-së, për kryetar komune në Ferizajt.

Neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar.

Sepse duke u mbështetur në dispozitat e parapara ligjore të LZP-së dhe Rregullat Zgjedhore, të cilat përcaktojnë të drejtat e subjekteve politike, si dhe veprimet e ndaluara të tyre vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, dhe duke marrë parasysh se veprimet e pretenduara të cilat janë paraqitur në ankesë janë zhvilluar para datës së përcaktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, si dhe duke u mbështetur në atë se asnjë dispozitë e paraparë e LZP-së dhe as Rregullat Zgjedhore nuk e parashohin sanksionimin apo marrjen e masave tjera ndëshkimore ligjore për vendosjen e pankartave dhe posterave publike apo edhe fillimin e fushatës zgjedhore para datës së përcaktuar për mbajtjen e saj.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 50/2012 më datën 24.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

